



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI**

**VENDIM**

**Nr.19, datë 14.12.2018**

**MBI QËNDRIMIN E SENATIT AKADEMIK LIDHUR ME SITUATËN E KRIJUAR PAS PROTESTAVE  
STUDENTORE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, neni 38, pika 1, Vendimin Nr. 9, datë 02.02.2009 të Senatit Akademik "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Senatit Akademik", si dhe në mbështetje të studentëve dhe të protestës së tyre civile, Senati Akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 14.12.2018,

**VENDOSI:**

1. Të mbështesë kërkesat e protestës së studentëve që po zhvillohet në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit.
2. Të mbështesë kërkesën për rritjen e financimit nga buxheti i shtetit me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, infrastrukturës dhe mundësinë e rishikimit të tarifave të studimit.
3. Universiteti Politeknik i Tiranës merr përsipër përgjegjësitë e tij dhe shpreh angazhimin gjithëpërfshirës të personelit akademik dhe studentëve për evidentimin dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave që i takojnë Universitetit Politeknik të Tiranës.
4. Universiteti Politeknik i Tiranës merr përsipër që nëpërmjet akteve të brendshme të mundësojë institucionalizimin e dialogut pedagog-student si mekanizmin real dhe transparent për zgjidhjen e problemeve në Universitetin Politeknik të Tiranës.
5. Universiteti Politeknik i Tiranës distancohet nga të gjitha qëndrimet dhe aktet, të çfarëdolloj natyre, që cënojnë figurën e pedagogut, studentit apo Institucionit dhe shpreh vullnetin e plotë për të vënë në funksion të gjithë mekanizmat e vet për të nxjerrë jashtë mjediseve universitare pjesëtarët e personelit të vet që thyejnë etikën akademike.

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
SENATI

6. Universiteti Politeknik i Tiranës angazhohet të vijojë të bëjë transparencën e buxhetit dhe shpenzimeve të kryera për çdo vit kalendarik.
7. Universiteti Politeknik i Tiranës propozon krijimin e një axhende politike dhe akademike për reformimin e sistemit të arsimit të lartë, ku:
  - Parimet kryesore të jenë transparenca dhe gjithëpërfshirja;
  - Cilësia akademike të jetë kryefjala e reformës dhe finaliteti i kësaj axhende;
  - Arsimi i lartë të shpallet prioritet kombëtar me buxhet solid dhe një plan investimesh madhore në 5 vitet e ardhshme;
  - Studentët, pedagogët dhe politika të ngrenë një komitet shtetëror me status të veçantë deri në realizimin e plotë të axhendës;
  - Në qendër të axhendës të jetë studenti dhe pedagogu, hallkat më të rëndësishme të sistemit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari  
**Prof. Dr. Andrea MALIQARI**

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al